



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A.

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
Ref-62618-09-25-2025

Objekti i procedurës: “Studim projektim:Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit per njesine Administrative Antigone dhe Lunxheri, Bashkia Gjirokaster”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 79415200-8 - Shërbime të konsulencës në projektim, 22114311-5 - Projekte

Vlera e fondit limit: 13,221,250.00 (trembëdhjetë milion e dyqin e njezet e nje mije e dyqin e pesedhjetë) Lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit , Buxheti i Shtetit, sipas Shkresës të Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2366 Prot, të datës 18.03.2025, Lënda “Dërgohet detajimi i buxhetit 2025-2027 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj për programin furnizim me ujë dhe kanalizime”, miratuar “Studim projektim:Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit per njesine Administrative Antigone dhe Lunxheri, Bashkia Gjirokaster”, në vlerat Buxheti për 2025: 8,225,000 lekë me tvsh, Buxheti për 2026: 8,226,000 lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster SH.A., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a” formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", (i ndryshuar).

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit ushtrimore 2022, 2023, 2024, vlera e të cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

c) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, si dhe neneve 43 dhe 47, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përmbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2022, 2023 dhe 2024, që rezultojnë të jenë përmbullur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiron vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përmbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor.

Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2022, 2023 dhe 2024, si mbas xhirove vjetore, të depozituara pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së bilanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiron vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e

raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 12-15 muaj.

Gjithashtu, për të vërtetuar kapacitetin ekonomik, operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti lokal për tre vitet e fundit, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ai ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së/QKB-së. Kjo kërkesë buron nga neni 76 i LPP-së, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, sipas të cilëve subjektet tregtare kanë detyrimin që të paguajnë taksat vendore, me qëllim që të ushtrojnë aktivitetin. Vitet përkojnë me 2022, 2023 dhe 2024. Të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik janë të bazuara në legjislacionin e përmendur më sipër dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse ofertuesit kanë kapacitete për të nisur dhe përfunduar punët publike që prokurohen. Po kështu, duke qenë se mund të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme në punët e realizuara, sipas nenit 41 të rregullave të prokurimit publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Punë të ngjashme për realizimin e një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; ose/dhe fatura tatimore të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme pranë subjekteve private, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. Dokumentet e mësipërme janë të mbështetura edhe në legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për ndërtimet.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Kjo kërkesë bazohet në nenet 88 e në vijim të LPP.,

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesi Liçencë Projektimi të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- 3.a Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- 4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 4.f Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- 5.b Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- 5.c Ujësjellës- kanalizime urbane – rurale.
- 5.f Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.
- 6.b Rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore.
- 7.b Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.
- 8.a Rilevime inxhinierike.

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. **Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.** (Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Sipas këtij kriteri, operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
3.a	Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit dhe preventivit paraprak, parashikohet projektimi për rikonstrukcion depo, ndertimin depo shperndarje si dhe ndertimin e vendrojeve. Si rrjedhojë kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
4.c	Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet projektimi për punimet elektrike, elektro-mekanike ne rikonstruktimin e depos ekzistuse, paisjeve ndihmese teknike, makinerive ne sherbim aktuale te depos, rrethimin e tyre si dhe ndricimin. Si rrjedhojë kjo pikë është e

		nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
4.f	Projektim të sistemeve kundra zjarrit	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet projektimi për vendosjen e hidranteve të zjarrit në linjat kryesore dhe llogaritjen e volumit rezerve të depozitave për këtë qëllim, si rrjedhojë kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
5.b	Projektim Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi	Bazuar në detyrën e projektimit, parashikohet realizimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonës rurale, si rrjedhojë kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
5.c	Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet mbulimi i plotë me rrjet ujësjellesi për të gjithë zonën e studimit duke plotësuar nevojën e furnizimit me ujë 24 ore. Realizimi i projektit të detajuar teknik përfshirë preventivin e punimeve për ndertimin e rrjetit shpërndares të ujësjellesit me të gjithë parametrat hidroteknik, si rrjedhojë kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
5.f	Projektim vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me pusë.	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet mbulimi i plotë me rrjet ujësjellesi për të gjithë zonën e studimit duke plotësuar nevojën e furnizimit me ujë 24 ore. Realizimi i projektit të detajuar teknik përfshirë preventivin e punimeve për ndertimin e rrjetit shpërndares të ujësjellesit me të gjithë parametrat hidroteknik përfshin linjë transmetimi dhe rrjet shpërndares. Gjykohet se këto kalime linjash mund të kalojnë në gjurmë me projekte të tjera infrastrukturore inxhinierike. Kjo sjell si rrjedhojë që të gjykohet se kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
6.b	Rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet që linjat e tubacioneve të vendosen në rrugë automobilistike me qëllim kontrollin dhe shmangjen e nderhyrjeve të paligjshme, për rrehabilitimin e rrugëve në gjendjen e meparshme nevojiten llogaritjet e shtresave rrugore, si rrjedhojë kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
7.b	Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet që linjat e tubacioneve të kalojnë në terren malor ku intersektohen perrenjtë të cilat është e nevojshme ndertimi i veprave të artit mbi 10m për kapërcimin e tyre, si rrjedhojë kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
8.a	Rilevime inxhinierike.	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet të kryhet rilevimi inxhinierik i rrugëve dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i ujësjellesit, të jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit, si rrjedhojë kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

2.3.3.Operatori ekonomik duhet të ketë Drejtues Teknikë të përfshirë në Licencën e Shoqërisë, si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale projektim,

CV, librezë pune, referenca per eksperience ne pune te ngjashme ujesjelles, Kualifikime, Çertifikata, Trainime dhe të figurojnë në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

- 1 (një) Drejtues Projekti Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Projektues Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Projektues Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) Projektues Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Projektues Inxhinier Mjedisi

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas shtojces 5.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin e suksesshëm të kontratës bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit 162/2020, “Për prokurim publik” dhe nenin 41, pika 4, gërma b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës së Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Për realizimin e këtij studim projektimi objekti nevojitet një ekip inxhinierësh të udhëhequr nga **Drejtuesi i Projektit** që ka detyra kryesore të lidhura kryesisht me drejtimin dhe koordinimin e ekipit të inxhinierëve të stafit, drjetimin e aktiviteteve kryesore për realizimin e shërbimeve, prodhimin e dokumentave kryesore si dhe raporteve që kërkohen sipas Detyrë Projektimi, si dhe mbajtjen e kontakteve me autoritetin kontraktor. Profili i këtij pozicioni kërkohet të jetë **Projektues Inxhinier Hidroteknik** pasi ky profil i përshtaten shërbimeve të kërkuara për projektimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve.

Projektues Inxhinier Ndërtimi, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e strukturave beton-arme me/pa prani të ujit të lidhura sidomos me llogaritjet inxhinierike të ndertesave të depove të ujit, pusetave të shkarkimit, pusetave të ajrimit, puseta të kontrollit, apo dhoma teknike të komandimit, kalimet e rrugëve kryesore dhe rrjeteve inxhinierike sekondare nëse do nevojitet. Gjithashtu nevojitet për kryerjen e llogaritjeve inxhinierike për përcaktimin e shtresave rrugore si dhe materialit që do të përdoret për mbushjen e kanaleve ku do të shtrohen linjat me qëllim sigurimin e aftësisë mbajtëse .

Projektues Inxhinier Gjeodet, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me rilevimin e kuotave gjeodezike, kordinative te rrugës dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i furnizimit me ujë, pusetave te kontrollit, pusetave te ajrimit, pusetave te shkarkimit, depove rregulluese, të jepet plani i piketimit në terren.

Projektues Inxhinier Elektrik, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht për punimet elektrike ne depo, paisjeve ndihmese dhe ndricimin.

Projektues Inxhinier Mjedis, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht për punimet mjedisore per rehabilitimin e mjedisit ne perfundim te punimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të ketë Staf Ndihmës si më poshtë, te vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, referenca per eksperience ne pune te ngjashme ujesjelles, Kualifikime, Çertifikata, Trainime:

1 (një) Inxhinier Hidroteknik i Çertifikuar per modelime hidraulike sisteme furnizimi me uje.

1 (një) Inxhinier Gjeolog/Hidrogeolog/Shpimi

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas shtojces 5.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës së Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, te cilet do të jenë të licensuar ose certifikuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Inxhinieri Hidroteknik kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me llogaritjet hidraulike për dimensionimin e tubacioneve të rrjetit të furnizimit me uje, bazuar në modelimin e sistemit si dhe llogaritjet hidraulike te tubacioneve te dergimit dhe shperndarjes, analizën e sistemit te përzgjedhur për të gjithë zonën e studimit, sipas kushteve teknike të projektimit.

Inxhinier Gjeolog/Hidrogeolog/Shpimi, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht, për të vlerësuar kapacitetin e burimit ekzistuese nese perballon kerkesen per uje te rrjetit te ujesjellesit.

2.3.5 Një punësim mesatar i të paktën 7 (shtatë) personave, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës e vërtetuar me:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
2. Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Përcaktimi i fuqisë punëtore minimale të kërkuar është bazuar në shpërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit objekt prokurimi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu duke ju referuar intensitetit të shërbimeve nevojitet operator ekonomik me staf të organizuar dhe të qëndrueshem për të garantuar shërbimet.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jenë licënsuar nga Q.K.L. me kodin III.2.A për “Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Auditim Mjedisor”

Argumentimi: Ky kriter bazohet në Nenin 3 të ligjit Ligji Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis” “...Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre...”.

Nevojitet për paisjen me Leje Mjedisore për tu paisur me Leje Ndertimi ose Infrastruktura nga pushteti vendor. Eksperti që harton raportin duhet të jetë i regjistruar në QKL sipas legjislacionit në fuqi ligjit Nr.10 081 , datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet Dhe Lejet Në Republikën E Shqipërisë” dhe VKM Nr.538 date 26.05.2009 “Për Licencat Dhe Lejet Që Trajtohen Nga Apo

Nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (QKL) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të Përbashkëta”

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Q.K.L. me kodin I.2.A për ”Sherbime ekspertize ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”

Argumentimi: Ky kriter bazohet ne Nenin 39, te Ligj Nr. 152/2015 “Për Shërbimin E Mbrojtjes Nga Zjarri Dhe Shpëtimin” “...*Projekti për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin është pjesë përbërëse e dokumentacionit që kërkohet për lëshimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit...*”

Nevojitet per paisjen me Leje nga sherbimi MZSH per tu paisur me Leje Ndertimi ose Infrastrukture nga pushteti vendor. Eksperti qe harton raporti duhet te jete i regjistruar ne QKL sipas legjislacionit ne fuqi ligjit Nr.10 081 , datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet Dhe Lejet Në Republikën E Shqipërisë”, VKM Nr.538 date 26.05.2009 “Për Licencat Dhe Lejet Që Trajtohen Nga Apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (QKL) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të Përbashkëta” si dhe per projektimin e vendosjes se hidranteve te zjarrit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat sipas Standarteve ISO, të vlefshme (ose ekuivalente), si me poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente: Sisitemi i Menaxhimit të Cilësisë.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ISO 14001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente: Sistemet e Menaxhimit Mjedisor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ISO 45001:2018 (e vlefshme) ose ekuivalente: Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.

(Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Keto certifikata lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përpërmbyshjen e plotë të kontratës.

Certifikata ISO përshkruajnë tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar të këtij shërbimi dhe që i vlerëson këtë shërbim si të pranueshem për funksionin e kërkuar, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Çertifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

2.3.9 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera Pajisjet Gjeodezike si më poshtë:

- 1 (një) Pajisje GPS

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

- 1(një) Pajisje Dron

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. *Pajisje GPS se bashku me Dronin kerkohen per te kryer matjet topografike dhe rilevime qe lidhen me pozicionimin e objekteve, rrugeve dhe kuotave gjeodezike, dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i furnizimit me ujë, pusetave te kontrollit, pusetave te ajrimit, pusetave te shkarkimit , depove, plani i piketimit dhe verifikimi në terren i të dhënave të projektit.*

2.3.10 Ofertuesit duhet të ketë në pronësi ose me qera Automjete, si më poshtë:

- 1(nje) Automjet

Për automjetin kur eshte në pronësi të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni dhe çertifikata e kontrollit teknik sipas legjislacionit ne fuqi. Për automjetet me qira krahas dokumentacionit të mësipërm të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë ku perfshihet periudha e sherbimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.11 Operatoret ekonomik, ne permbushje te pikes 4.4, germa A) duhet te paraqesin (i) *Përvoja per Punë të Ngjashme të Operatorit Ekonomik*, (ii) *Metodologjia e Propozuar*, (iii) *Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar* per qellim te vleresimit me pike te propozimit teknik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 2/b dhe 5 të nenit të 87, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 45, pika 4 dhe 9, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

2. Oferta ekonomike më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor; në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës;

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomike më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomike më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

9. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse.

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

a) Për kriteret, që mund të përdoren për propozimet teknike, autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

i. Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit;

ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;

iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

Nënkriteret e kriterëve të vlerësimit teknik do të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit për shërbimet.

b) Vlerësimi i propozimeve ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për propozimin ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{Çu}{Ç}$$

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë ofertën (Shtojca 1 dhe 2) dhe në përlogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" i azhurnuar. Mbi çmimin e ofertes do të bëhet vlerësimi me pike të propozimit ekonomik.

Argumentimi: Kriteri bazohet në rekomandimin e Agjensia e Prokurimit Publik me shkresë Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016" dhe shkresës Nr. 13565 Pro.t datë 06.11.2017 "Terheqim Vemendjen". Me qëllim garantimit të realizimit të shërbimit në kohë dhe me cilësi është gjykuar se respektimi i legjislacionit në fuqi është i domosdoshëm.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".